



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.1560/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Super Viva” SH.P.K., NUI: 810800385, me seli në Zonën Industriale 4 (ish Thertorja) në Fushë Kosovë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.507/23 të datës 18.09.2023, me datën 21.03.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e debitorit “Super Viva” SH.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.507/23 të datës 18.09.2023, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.507/23 të datës 18.09.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Super Viva” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.287/23, i datës 10.03.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 09.03.2023 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbarimor -Vendimit Nr. 01/08-381/2021A i datës 18.01.2022, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbarimit, ndaj debitorit “Super Viva” Sh.p.k., me seli në Prishtinë të cilin e ka detyruar që t’ia paguaj shumën e borxhit prej 10,000.00 €, në emër të masës ndëshkimore si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore, me bllokimin e llogarive bankare, regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin si dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Përmbaruesi privat Isa Gacaferri nga Prishtina sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.287/23, i datës 10.03.2023, ka lejuar përmbarimin ndërsa debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor duke kundërshtuar tërësisht urdhrin e lejuar për përmbarim, duke theksuar se vendimi në fjalë akoma nuk mund të konsiderohet se është vendim administrativ i plotfuqishëm dhe përmbarimor, për arsye se tanimë veçse ka filluar konflikti administrativ pranë gjykatës kompetente. Më tutje ka theksuar se vendimet administrative të kreditorit përmbajnë të dhëna të paqarta, kontradiktore dhe janë të pasakta. Gjykatës i ka propozuar që ta anuloj urdhrin përmbarimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar thëniet në prapësimin e debitorit duke theksuar se procedura e zhvilluar është në përputhje me dispozitat

ligjore. Në lidhje me padinë e ushtruar nga ana e debitorit ka theksuar se vendimet e kreditorit janë të ekzekutueshme dhe ushtrimi i padisë në konflikt administrativ nuk e ndalë ekzekutimin. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzojë prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin për përmbarrim.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar pas vlerësimit të prapësimin ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.507/23 të datës 18.09.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Super Viva” Sh.p.k., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.287/23, i datës 10.03.2023, i lejuar nga Përmbarruesi Privat Isa Gacaferi. Me arsyetim se vendimi nr.01/08-381/2021A të datës 18.01.2022, në bazë të së cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin dhe gjeti se i njëjti, conform nenit 22 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si document përmbarrues sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimit për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se vendiminr.01/08-381/2021A I datës 18.01.2022 i përmban të gjitha elementete përcaktuara në nenin 27 paragrafi 1 të LPP-së. Ndër të tjera ka cek se vendimi në fjalë është bërë i formës së prerë me datë 06.03.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 06.03.2023.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përmbarrimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të ankimuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbarrimore. Kjo gjykate vlerëson se në rastin konkret vendimi i Inspektorati i Punës me Nr.01/08-381/2021A të dt.18.01.2022 për shumën në lartësi prej 10.000.00€ në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarrimor me titull

ekzekutiv, sepse i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 21 dhe 22 të LPP-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dokumenti mbi të cilin është lejuar përmbarimi, vendimi i Inspektorati i Punës, përbën bazën juridike për caktimin e përmbarimit, pasi që paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, në të cilin përcaktohet se “ *Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshme, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”, dhe nenit 22 par.1 pika 1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohen dokumentet përmbaruese siç janë “*Vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi*”, e edhe sipas nenin 27 paragraf 1 te LPP i cili përcakton se: “*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit* ”, e që në rastin konkret Vendimi me Nr.01/08-381/2021A të dt.18.01.2022 i përmban elementet e një vendimi të organit administrativ, dhe se e ka cilësinë e dokumentit përmbarues sipas nenit 21 dhe 22 par.2, LPP-së.

Andaj, Gjykata Komerciale – dhoma e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se vendimi mbi të cilin përmbaruesi privat e ka lejuar urdhrin përmbarimor të debitorit me Nr.01/08-381/2021A të dt.18.01.2022 paraqet dokument përmbarimor në kuptim të dispozitave të LPP-së, për shkak se përmban vulën e ekzekutueshmëris datës 06.03.2023 dhe plotfuqishmërisë datës 06.03.2023, si dhe vendimi mbi bazën e të cilit është nxjerrë urdhri përmbarimor i plotëson kushtet në kuptim të nenit 22 par.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimor.

Në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoi përmbarimin.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se lidhur me këtë çështje ka iniciuar konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, mirëpo gjeti se bazuar në dispozitën e nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, paraqitja e padisë nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përmbare dhe si rrjedhojë nuk e ndalon përmbarin.

Kështu, dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të debitorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitorë për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e mos kryerjes së përmbarit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur me këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1560/23, me datë 21.03.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija Ymeri

